

**VENDIM**  
**Nr. 600, datë 25.9.2024**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 173, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË PËRKOHSHME SHTETASVE**  
**UKRAINAS, PERSONAVE PA SHTETËSI DHE PERSONAVE QË KANË FITUAR**  
**MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË UKRAINË, ME VENDQËNDRIM TË**  
**PËRKOHSHËM OSE TË PËRHERSHËM NË UKRAINË, SI DHE PËR KRIJIMIN**  
**E TASK-FORCËS PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË KËRKUESVE TË**  
**MBROJTJES NDËRKOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 3/3, të vendimit nr. 173, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e Task-Forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuësve të mbrojtjes ndërkombëtare”, të ndryshuar, shtohet pika 3/4, me këtë përmbajtje:

“3/4. Me përfundimin e afatit, të përcaktuar në pikën 3/3, të këtij vendimi, personave që ndodhen ende në territorin e Republikës së Shqipërisë u shtyhet qëndrimi deri në datën 17.3.2025.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**